



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).



Organizata Milieukontakt Shqipëri, në kuadër të programit [ReLOaD2](#) është duke zbatuar projektin “Mjedisi i pastër, shëndet dhe edukim cilësor në shkollat e Paskuqanit”, i cili bashkëfinancohet nga Bashkia Kamzë. Përfituesit në këtë projekt janë Njësia Administrative Paskuqan, shkolla e mesme “Gramoz Palushi” dhe shkolla 9-vjeçare “Jashar Hoxha”.

Projekti do të zbatohet në shkollat e Nj.A Paskuqan, liqeni i Paskuqanit dhe zonat pranë bregut të Lumit të Tiranës, pasi ndër vite kanë qenë zona problematike, përse i përket ndotjes së mjedisit dhe dëmit që i shkaktohet ujërave të lumit nga hedhja e mbeturinave në brigjet e tij. Cilësia jo e mirë e ujërave të Lumit të Tiranës, ndikon negativisht jo vetëm për komunitetin që jeton në zonat pranë lumit, por edhe tek komunitetet e tjera, ku këto ujëra më pas rrjedhin, për t’u derdhur në ujërat e Adriatikut; pra ndotja nuk është statike, ajo rrjedh nga një zonë në tjetrën. Kjo situatë mund të përmirësohet duke: i) informuar dhe ndërgjegjësuar komunitetin për gjendjen dhe pasojat/rrezikun që vjen nga kjo ndotje, ii) vepruar konkretisht, duke përbushur detyrën qytetare për mirëmbajtjen dhe pastrimin e mjedisëve ku jetojmë, përmirësuar infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve, rritur rastet dhe modelet e riciklimit; rikthim të mjedisëve të caktuar, në zona të pastra dhe peizazhe të bukur, çlodhës dhe të shëndetshëm për të gjitha grupmoshat e komunitetit, duke mbjell bimë apo pemë të përshtatshme për habitatin ekzistues.

Ndonëse ka patur e vazhdon të ketë nisma për pastrimin e brigjeve të lumenjve, me këtë projekt synojmë që data të caktuar mjedisore nxënësit t’i kthejnë në rit të shkollës, duke vepruar dhe promovuar për një bashkëpunim mes institucioneve arsimore, komunitetit dhe grupet me të ardhura të pakta financiare. Përgjatë orëve mjedisore që do të zhillohen, mësuesit dhe nxënësit do të inkurajohen të krijojnë grupet e ekologut në çdo shkollë. Gjatë aktiviteteve do të nxitet dhe mbështetet me infrastrukturë të caktuar ndarja e mbetjeve, si dhe lidhet një kontratë bashkëpunimi mes shkollave dhe kompanive të riciklimit të letrës dhe plastikës. Objektivat kryesore të projektit janë:

Objektivi 1: Informimi/edukim dhe angazhimi i nxënësve për rëndësinë e një mjedisi të pastër, si komponent i rëndësishëm, që garanton një cilësi të mirë jete dhe brenda standardeve.

Objektivi 2: Rritja e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit dhe Njesisë Administrative Paskuqan për përmirësimin e mjedisit e zhvillimin e qëndrueshëm të tij, duke vepruar konkretisht për klimën, tokën dhe ujin.

Rezultatet e projektit do të jenë:

- Pastrimi dhe largimi i mbeturinave në dy zona pilot në Nj.A. Paskuqan pranë bregut të Lumit të Tiranës.
- Përmirësim të peizazhit pranë liqenit të Paskuqanit, duke bërë të mundur mbjelljen e 35 pemë bli dhe 30 pemë lis.
- Ditë të hapura mësimore me nxënës për temat: i) shëndeti i mirë, ii) qytete dhe komunitete të qëndrueshme, iii) veprime konkrete për klimën, jetën në ujë dhe tokë, iv) menaxhimi i mbetjeve (ndarja në burim, ripërdorim, riciklim).

Projekti do të zbatohet përgjatë periudhës 1 prill-30 nëntor 2022.

Ky projekt mbështetet nga Programi Rajonal [ReL OaD2](#) për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNDP.